



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

---

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL I MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE  
DHE TË LETËRSISË  
PËR MARRJEN E SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT 2016**

**I. HYRJE**

Programi i zhvillimit profesional i mësuesve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë për marrjen e shkallëve të kualifikimit është hartuar nga një grup pune, i cili është ngritur në Institutin e Zhvillimit të Arsimit (IZHA). Ky program iu vjen në ndihmë të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve, si dhe të gjithë mësuesve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë për t'u përgatitur për marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi është ndërtuar duke iu përgjigjur kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Ai është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore, në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumentet zyrtare<sup>1</sup>, të cilat kanë të bëjnë me veprimtaritë mësimore dhe edukative të mësuesve;
- programet përkatëse lëndore: Gjuhë shqipe (klasat 1-9), Gjuhë shqipe dhe letërsi (klasat 10-12, bërthamë), Letërsi (klasat 10-12, me zgjedhje);
- aspekte të përgjithshme të pedagogjisë dhe të metodologjisë në procesin e mësimdhënies;
- aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë së lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;

---

<sup>1</sup> Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë, duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- përmbajtja shkencore e gjuhës shqipe dhe e letërsisë, sipas programeve lëndore përkatëse.

## II. QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve është hartuar për të mbështetur dhe për të nxitur zhvillimin profesional të tyre. Programi mban parasysh përmbushjen e dy qëllimeve kryesore:

- *Së pari*, të ofrohet si një program i detyruar, veçanërisht për mësuesit që këtë vit do të marrin shkallët e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje gjithëvjetore e të përballojnë me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar për marrjen e shkallëve të kualifikimit.
- *Së dyti*, të ofrohet si një program orientues për t'u ardhur në ndihmë Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve, si dhe të gjithë mësuesve të lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese në bazë rrethi. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete.

### Programi mundëson:

- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe për zbatimin e legjislacionit arsimor dhe, në mënyrë të veçantë, të risive më të fundit të reformës arsimore.
- Rritjen e aftësive dhe të kompetencave profesionale të mësuesve për të ndikuar në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe të komunikimit në punën e tyre në shkollë.
- Rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe.
- Realizimin në praktikë nëpërmjet demonstrimit konkret të aftësive të fituara e, në mënyrë të veçantë, nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

### III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e shkallëve të kualifikimit është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër, për të cilat testohen mësuesit. Për secilin fushë janë renditur rezultatet e pritshme që duhet të demonstrojë mësuesi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Programi është ndërtuar duke pasur si pikënisje standardet bazë të përgjithshme të mësuesit, si dhe standardet e mësuesit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij, si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Në këtë format, për secilën fushë prezantohen kompetencat që mësuesit duhet të zotërojnë në fushën e njohurive dhe të aftësive, si dhe literatura përkatëse rekomanduese që iu vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

#### Përmbajtja e programit sipas fushave

<b>FUSHA : DOKUMENTET ZYRTARE</b>	
<b>Kompetenca:</b> Zbatimi me përgjegjshmëri dhe korrektesë i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor.	<b>Literatura e rekomanduar</b>
Rezultatet e pritshme Mësuesi: - njeh dhe zbaton ligjin “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe Dispozitat Normative të këtij sistemi; - njeh dhe zbaton udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;	- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. - Urdhri për miratimin e Dispozitave Normative për arsimin parauniversitar (DN), nr 343, datë 19.08.2013. - Udhëzimi nr. 25, datë 17.08.2015 “Për vitin shkollor 2015-2016 në sistemin arsimor parauniversitar”.

<ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh dhe zbaton legjislacionin për personelin e shkollës;</li> <li>- demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve, urdhrave dhe rregulloreve të MAS-it, në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies;</li> <li>- njeh dhe zbaton etikën profesionale të mësuesit;</li> <li>- respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e nxënësit;</li> <li>- respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li> <li>- njeh dhe zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Korniza kurrikulare, 2014.</li> <li>- Udhëzimi nr. 44, datë 16.10.2014 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore - edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”.</li> <li>- Udhëzimi “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore”, 2016.</li> <li>- Udhëzimi nr. 5, datë 25.02.2013 “Për standardet e mësuesit”.</li> <li>- Udhëzimi nr. 26, datë 15.08.2015 “Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë”.</li> <li>- Udhëzimi “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”, 2016.</li> <li>- Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”.</li> <li>- Udhëzimi nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”.</li> <li>- Karta e performancës së shkollës.</li> <li>- Standardet e shkollës si qendër komunitare.</li> </ul>
---	---

**FUSHA: PROGRAMET LËNDORE**

**Kompetenca:** Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë në shkollë.

**Literatura e rekomanduar****Rezultatet e pritshme**

Mësuesi:

- njeh dhe zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij;
- përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e klasës në të cilën jep mësim;
- përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit;
- gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe të aftësive të parashikuara në program;
- gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre;
- harton objektiva/rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me qëllimet e programit;
- harton objektiva specifike/rezultate të nxëni që u përgjigjen niveleve të ndryshme të nxënësve;
- tregon dhe zbaton koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe

- Programet aktuale lëndore të gjuhës shqipe për arsimin bazë, klasat 1-9.
- Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat 6-7.
- Programet aktuale lëndore të gjuhës shqipe dhe të letërsisë (bërthamë) për arsimin e mesëm të lartë, klasat 10-12.
- Programet aktuale lëndore të letërsisë (me zgjedhje) për arsimin e mesëm të lartë, klasat 10-12.
- Programet aktuale lëndore të gjuhës shqipe dhe të letërsisë për gjimnazet gjuhësore dhe për arsimin profesional.
- Programet aktuale lëndore të gjuhës shqipe dhe të letërsisë për arsimin e orientuar (social -kulturor).

<p>përshatshmëria e programeve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegon dhe zbaton lidhjen program-tekst nxënësi- plan mësimor vjetor;</li> <li>- për zgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit;</li> <li>- siguron informacion që demonstroi lidhjen e gjuhës dhe të letërsisë me shkencat e tjera dhe me jetën reale.</li> </ul>	
---	--

**FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK –UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE**

<p><b>Kompetenca 1:</b> Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe të letërsisë.</p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b> Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij;</li> <li>- përshat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve;</li> <li>- demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit;</li> <li>- identifikoi nxënësit me nevojë të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar);</li> <li>- planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevojë të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij.</li> </ul>

<p>veçanta;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi qëndrim pozitiv ndaj gjuhës dhe letërsisë;</li> <li>- edukon të nxënësit dashurinë dhe kërkueshmëri ndaj lëndës;</li> <li>- motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin, një nga çelësat e progresit të tyre;</li> <li>- krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;</li> <li>- punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.</li> </ul>	
<p><b>Kompetenca 2:</b> Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe të letërsisë.</p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të caktuar;</li> <li>- planifikon orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;</li> <li>- përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve;</li> <li>- përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve;</li> <li>- përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen;</li> <li>- përdor teknika dhe instrumente të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese, mësimdhënies me në qendër nxënësin, metodologjinë e mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe të letërsisë.</li> <li>- Udhëzues dhe materiale mbështetëse që orientojnë për hartimin e objektivave të orës së mësimi, përgatitjen e planit ditor dhe organizimin e orës së mësimi.</li> </ul>

<p>ndryshme për vlerësimin e nxënësit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ndërton një test duke zbatuar parimet e hartimit të një testi.</li> </ul>	
<p><b>Kompetenca 3:</b> Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies së gjuhës shqipe dhe letërsisë.</p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- prezanton materiale mësimore duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Word, Power Point, Excel;</li> <li>- nxit nxënësit të bëjnë prezantime gjatë orës së mësimit duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta;</li> <li>- gjen dhe përdor materiale nga website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien;</li> <li>- përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së gjuhës shqipe apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga burime të ndryshme në internet.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Literaturë që ka në fokus përdorimin e programeve kompjuterike (Word, Excel, Power point).</li> </ul>

**FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT**

<p><b>Kompetenca:</b> Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të</p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
--	--



domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit.	
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh rregullat e etikës dhe të sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, kolegët, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;</li> <li>- zbaton rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kodi i etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar publik dhe privat, datë 30.11.2013.</li> </ul>

<b>FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE</b>	
<b>Kompetenca:</b> Zbatimi i rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe.	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njeh dhe zbaton rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe;</li> <li>- vlerëson rëndësinë e përdorimit të gjuhës standarde në të gjithë veprimtaritë dhe punët e tij në shkollë dhe jashtë saj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.</li> </ul>

**FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS**

<b>Kompetenca:</b> Respektimi i përmbajtjes shkencore të lëndës.	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- analizon dhe jep gjykimet e tij për letërsinë shqipe e botërore, për periudhat dhe drejtimet letrare, si dhe për shkrimtarët përfaqësues dhe krijimtarinë e tyre letrare;</li><li>- kupton, interpreton, analizon dhe vlerëson tekste e fragmente të ndryshme letrare dhe joletrare;</li><li>- analizon dhe vlerëson tiparet e stilit dhe të gjuhës në një tekst ose fragment;</li><li>- kryen analiza të sakta nga fusha e sistemit gjuhësor të shqipes;</li><li>- respekton rregullat gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Tekste të lëndës për mësuesin dhe për nxënësin, materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës.</li></ul>